



Pranuar / Dërguar Përmblen/Prodato Received/Delivered	18-01-2023	viti Year	3
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shitje e Printoj Appendix	Sasia Kohësira Quantity
SKM/SHCK	508/2023		1/8



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1015/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1015/2022 të datës 16.11.2022 të parashtruar nga ankesja avokat nga Prishtina, kundër Vendimit me Nr.143/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me bazë ankimore "kundërshtim i trajnsferimit për shkak të ristrukturimit t", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1015/2022 e datës 16.11.2022, e parashtruar nga ankesja

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.143/2022 i datës 10.11.2022 dhe Vendimi me Nr.18/2022 i datës 10.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa detyrohet Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të nxjerrë raport meritor lidhur me sistemin e ankueses në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja

më datë 16.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli

7161/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.143/2022 të datës 10.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve procedurale dhe shkeljeve materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 25.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 02.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK.Nr.199/2022 të datës 27.12.2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1015/2022 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7161/2022 e datës 16.11.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtruar nga ankuesja; Autorizimin e datës 19.09.2022; Kontratën e Punës të datës 01.09.2003 për ankueses; Kontratën e Punës me Nr.3/2006 e datës 15.04.2006 për ankuesen; Kontratën e punës me Nr. 4/2007 e datës 01.04.2007 për ankuesen; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të kontratës 206/2011 të datës 11.05.2011; Akt Emërimit e datës 06.02.2012 për ankuesen; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me Nr. 072/2012 i datës 16.09.2013 për ankuesen; Vendimin me Nr.Ref: 768/2018 të datës 10.09.2018; Vendimin me Nr.1402022 të datës 15.09.2022 të DMZP-së; Kërkesën për dhënien e një kopje të dosjes së ankueses e datës 21.09.2022; Kërkesën për dhënien e një kopje të përkrahimit të detyrave të punës Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm e datës 22.09.2022 nga ankuesja; Vendimin me Nr. 143/2022 të datës 10.11.2022 të DMZP-së; Raportin Specialisti i datës 04.02.2022, 27.01.2022; Raportin nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës i datës 03.02.2022; Raportin kthyes nga diagnostika i datës 12.11.2021; Raportin nga konsulta i datës 21.04.2021; Raportin Mjekësor i datës 07.12.2021; Raportin Specialistik i datës 21.07.2021; Certifikatën e datës 31.01.2008, 08.06.2007, 24.05.2022; Certifikatën e trajnimit maj 2022; Certifikatën e trajnimit e datës 25.09.2015; Certifikatën e datës 27.12.2016; Certifikatën dhjetor 2009; Certifikatën e datës 02.05.2008; Certifikatë e martesës me Nr. M 11354585 e datës 28.02.2022; Certifikatëne trajnimit e datës 03.06.2010; Certifikatë trajnimi për periudhën 16-21.10.2011; Certifikatë e datës 29.08.2003; Certifikatën e datës 24.11.2005; Certifikata me Nr.20/15 e datës 15.01.2002; Certifikatë e datës 18.02.2020; Formulari i Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për vitin 2020 i datës 30.01.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 7400/2022 e datës 25.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7588/2022 e datës 02.12.2022; Raportin e Veçantë të Komisionit të Ristrukturimit me numër protokolli 1620 i datës 01.11.2022; Përkrahimi i detyrave të punës për udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike; Përkrahimin e punë për pozitën udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MPJD i datës 30.09.2022; Akt Emërimit me numër AE.Nr.61/2022 i datës 13.06.2022 për H.B; Vendimin me Nr. 18/2022 të datës 10.05.2022 të DMZP-së; Diplomën me Nr. 5221 për H.B; Diplomën me Nr. 71 për H.B; Licencë me numër 113/2018 e datës 15.02.2018 për H.B; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me Nr. Port: 87 i datës 01.02.2018 për H.B; Akt Emërimit me Nr. Ref: 605/2014 i datës 06.05.2015 për H.B;

Formularin e Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për vitin 2021 i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.01.2021, 31.12.2019, 24.12.2018, 20.07.2017, 29.12.2016, 22.12.2015, 30.12.2014, 30.12.2013; Listën për pjesëmarrje në trajnimin në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional; Certifikatën për periudhën 06-10.11.2022 për H.B; Certifikatë e Avancuar Profesionale për Prokurim e vitit 2022; Certifikatën për trajnim tetor 2022; Certifikatën e datës 24.05.2022; Njoftim për programin e trajnimit të Avancuar profesionale për prokurim; Certifikatë e trajnimit e datës 13.08.2011; Emailin e datës 30.11.2021 nga S.B; Certifikatën e trajnimit gusht 2021; Certifikatën e trajnimit për periudhën 23-24.03.2021 për H.B; Certifikatë nme Nr. Port:112/2021 e datës 22.06.2021; Emailin e datës 04.12.2020 nga H.B; Certifikatën për trajnim për periudhën 29-30.09.2020 për H.B; Emailin e datës 01.12.2020 nga V.H; Certifikatën e trajnimit për periudhën 15-16.10.2019; Certifikatën nga KAF e datës 16.12.2018; Certifikatë trajnimit për periudhën 11, 21 dhe 22.03.2019; Raport për pjesëmarrje në trajnim i datës 04.01.2019; Lista e kandidatëve që kanë kaluar testin/2018; Certifikatën trajnimit për periudhën 27-28.09.2018; Certifikatë trajnime për periudhën 02-03.05.2018; Certifikatën e trajnimit për periudhën 29-30.11.2018; Emailin e datës 18.09.2018 nga S.B; Certifikatën e datës 10.11.2017; Certifikatën e muajit qershor 2016; Licencën me Nr. VP-251 e datës 06.06.2017; Certifikatë trajnimit prill 2017; Certifikatë e datës 11.04.2017; Certifikatë për periudhën 26-29.01.2017; Certifikatën e trajnimit për periudhën 02-03.03.2016 për H.B; Certifikatën e datës 29.05.2016; Certifikatën Themelore Profesionale të Prokurimit 2015-2017; Certifikatë e datës 02.12.2013; Certifikatën e trajnimit për periudhën 27-28.02.2013; Certifikatën për trajnim për periudhën 26-27.03.2015; Certifikatën për periudhën 20, 21,20.04.2012; Formulari i Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm i datës 24.10.2018, 31.10.2017, 31.10.2016, 31.12.2011, 26.10.2012; Masën disiplinore Vërejtje me Nr. Ref: 177/20022 e datës 25.03.2022 për ankuesen; Licencë e datës 15.02.2017; Certifikatën e datës 10.08.2010 për ankuesen; Certifikatën për periudhën 02-05.12.2009 për ankuesen; Certifikatën e datës 21.11.2018 për ankuesen; Emailin e datës 23.11.2022 nga A.K; Emailin e datës 15.11.2022 nga B.I; Vendimin VK.nr.199/2022 i datës 27.12.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Kodin RPC0002401 të datës 28.03.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Konkursin me Kodin RPC0002139 të datës 19.04.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, si dhe Konkursin me Kodin RPC0000583 të datës 26.04.2021 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në ministrinë e Zhvillimit Rural.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses është e bazuar, *Sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç'rast si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve për pozita të caktuara. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar Komisioni i Ristrukturimit), kurse, me Vendimin me shenjë VPD

Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 ka miratuar përshkrimin e detyrave të punës të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me tej nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi ankuesja sipas Aktit të Emërimit nr.072/2012 të datës 16.09.2013 ka qenë e emëruar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Auditimit të Brendshëm në ish Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo që për këtë pozitë kanë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht janë përcaktuar kriteret shtesë lidhur me kualifikimet e posaçme formale, rrjedhimisht si kriteret për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Certifikim për Auditim të Brendshëm për Sektorin Publik, Certifikim dhe menaxhim të përgjithshëm në fusha tjera të ngjashme, Edukim i Vazhdueshëm Profesional - minimum gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme sipas kërkesave të përcaktuara ligjore.*

Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022, ka konstatuar së ankuesja ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm mirëpo e njëjta nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale të miratuara nga DMZP-ja lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional-minimumi 60 orë trajnim brenda 2 vetëve të njëpasnjëshme sipas kërkesave të përcaktuara ligjore, andaj, meqenëse ankuesja nuk plotëson kriteret e posaçme për asnjë pozitë tjetër të lirë në MPJD, propozon që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse sipas Raportit plotësues të datës 22.04.2022 propozon që ankuesja të transferohet në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Raportime Financiare në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me Vendimin Nr.140/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ankuesja është transferuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publikë

Ankuesja më datë 22.08.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me mos sistemimin e ankueses, ndërsa, Këshilli më vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, ka anuluar Vendimin Nr.140/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, më Raportin e Veçantë të Punës të datës 31.10.2022, ka konstatuar së ankuesja nuk mund të sistemohet përkatësisht të transferohet në ndonjë pozitë të lirë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak së e njëjta nuk ka plotësuar kushtet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja, duke propozuar që ankuesja të transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Bazuar në propozimi e Komisionit të Ristrukturimit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve

Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.11.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.142/2022 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerrë më shkelje procedurale dhe materiale, duke shtuar së procedura e transferimit të ankuses është bërë në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse nuk është përmbushur kushti ligjor i transferimit gjegjësisht ai i shuarjes së pozitës së ankuses dhe së Komisioni i Ristrukturimit ka cenuar statusin shtesë të ankuesit duke mos i marrë parasysh nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht statusin e veçantë të nëpunësit civil pasi që të njëjti sipas legjislacionit për shërbim të jashtëm mbajnë grada diplomatike. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin me numër 143/2022 të datës 10.11.2022 të zëvendësueses së Drejtores së DMZP-së, si dhe Rekomandimin me numër protokoll 1620 të datës 01.11.2022 të Komisionit të Ristrukturimit dhe të obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së që ankuesen ta kthej në pozitën e Udhëheqëses së Divizionit të Auditimit të Brendshëm duke i kompensuar të gjitha pagat dhe benificionet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës sipas Aktit të Emërimit Nr.072/2012 dhe Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të datës 16.09.2013, duke filluar nga data 10.11.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit. 4. Nëpunësi mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 52 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirimin nga Shërbimi Civil. 5. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, drejtohet nga njësia e pranimit dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij neni, sipas rastit.."*

Ndërsa me Rregulloren (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 13 është përcaktuar se: *Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës. 2. Në rast se paraqiten rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristraktuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në Nenin 54 paragrafin 2 të Ligjit. 3. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar apo të shuar njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit... ndërsa me nenin 14 është theksuar se: 1. Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse brenda 15 dite të*

aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori..... 3. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e themelimit i propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil siç parashihet në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit; 4. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Vendimi është individual për çdo nëpunës civilë. 5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet. 6. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter.

Në kuptim të dispozitave ligjor si me sipër, si dhe referuar konstatimit të Komisioni i Ristrukturimit së ankuesja Mybera Hyseni ka plotësuar kriterin e arsimit dhe përvojës së punës lidhur me pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Auditim të Brendshëm, por e njëjta nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me edukimin e vazhdueshëm prej (60) orë trajnim brenda dy (2) viteve, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, gjegjësisht nenin 22 paragrafi 2 të këtij ligji më të cilën është përcaktuar se: “..2. Auditorët e njësisë së auditimit të brendshëm duhet të kenë kualifikimet si në vijim: 2.1. diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet; 2.2. certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave. Ndërsa nenin 25 paragrafi 1 të të njëjtit ligj është parapare se: “Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm: 1.1. ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministri i Financave; 1.2. veprojnë në përputhje me kriteret e përcaktuara në kodin e etikës, planin e auditimit dhe rregullat për konfidencialitet për auditimin e brendshëm; 1.3. zhvillojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, dhe ruajnë certifikimin e tyre profesional duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 22 në këtë Ligj..” si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit referuar kësaj baze ligjore vlerëson së trajnimi gjashtëdhjetë (60) orë brenda dy viteve të njëpasnjëshme, nënkupton detyrimin e auditorëve për zhvillim të vazhdueshëm profesional përmes ndjekjeve të trajnimeve nga fusha relevante e auditimit të brendshëm, si kërkesë ligjore për të ruajtur certifikatën e auditorit të brendshëm, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit trajnimi në fjalë nuk përbën kriter të përgjithshëm formal për emërimin dhe ushtrimin e funksionit të Auditorit të Brendshëm në Sektorin Publik siç është pretenduar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Ashtu siç është konstatuar edhe në Vendimin e Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 30 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave si dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores QRK-Nr.01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik, vlerëson së është përgjegjësi ligjore e Njesisë Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, që të hartoj dhe administroj politikat kombëtare për trajnimin, certifikimin dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional të auditorëve të brendshëm, sipas praktikave ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm përmes organizmit të trajnimeve përfshirë edhe përgjegjësinë për

tërheqjen e certifikimit, ndërsa, organi punëdhënës është përgjegjës të siguroj mjete buxhetore për këtë qëllim, rrethana këto që Komisioni i Ristrukturimit nuk i kishte marrë parasysh në procedurë të rishqyrtimit lidhur me sistemin ankueses, përkatësisht Komisioni i Ristrukturimit nuk kishte marr parasysh faktin së ankuesja ka aktive Certifikatën e Auditorët të Brendshëm me numër 114/2016 të datës 27.12.2016 të lëshuar nga Njësia Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave dhe po ashtu Komisioni i Ristrukturimit ka dështuar të vërtetoj faktet nëse organet përgjegjëse kanë planifikuar dhe siguruar për dy vitet e fundit trajnime relevante në funksion të edukimit të vazhdueshëm të auditorëve të brendshëm në kuadër të sektorit publik apo nëse ankuesja të ketë refuzuar ndjekjen e këtyre trajnimeve.

Për sa më sipër, Kolegji thekson faktin së edhe në praktiken institucionale, edukimi i vazhdueshëm prej gjashtëdhjetë orëve trajnim nuk përcaktohen si kriter formal për praninë në pozitën e Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm. Në këtë kontekst, Kolegji ju referuar Konkursit me kodin RPC0003595 i datës 05.09.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Agjencinë e Privatizimit, Konkursit me Kodin RPC0002401 të datës 28.03.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Konkursit me Kodin RPC0002139 të datës 19.04.2022 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, si dhe Konkursit me Kodin RPC0000583 të datës 26.04.2021 lidhur me pozitën e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm në ministrinë e Zhvillimit Rural.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor së Komisioni i Ristrukturimit ka cenuar statusin shtesë të ankueses, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *"1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve"*, si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku me nenin 2 është përcaktuar se: *"..Gradat Diplomatike dhe Konsullore"- janë titujt e dhënë ose të fituar të përfaqësuesve diplomatikë dhe konsujve, të renditur sipas përparësisë ose epërsisë hierarkike.."*, rrjedhimisht nga analizimi i shkresave të lëndës është konstatuar së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme që nga data 11.05.2011 dhe së e njëjta ka fituar gradën diplomatike "Sekretar i Parë" sipas Vendimit Nr.ref.768/2018 të datës 10.09.2018 të Ministrisë së MPJD-së, andaj, në vlerësimin e Kolegjit nëpunësit civil që kanë të përveçësuar grada diplomatike në pajtim me legjislacionin e shërbimit të jashtëm, duhet të sistemohen brenda organin punëdhënës në këtë rast MPJD-së, duke aplikuar procedurën e sistemit në pajtim me dispozita e nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 14 të Rregullores(QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ndërsa nëse sistemimi sipas këtyre dispozitave nuk është i mundur për shkak të mungesës së pozitave të kategorisë së njëjtë apo mos përmbushjes së kriterëve për pozitë të kategorisë së njëjtë, me pëlqimin e nëpunësit civil sistemimi mund të behët në pozitë të kategorisë më të ulët duke respektuar përmbushjen e kriterëve për këtë pozitë të punës, përjashtimisht nëse sistemimi nuk është i mundur sipas kësaj procedure, atëherë, mund të rekomandohet sistemimi i nëpunësit civil në një institucion tjetër të Shërbimit Civil.

Kolegji i Këshilli bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lart, vendosi që të shfuqizohet Vendimi me Nr.143/2022 i datës 10.11.2022 dhe Vendimi me Nr.18/2022 i datës 10.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, detyrohet Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të nxjerrë raport meritor lidhur me sistemimin e ankueses në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.

Përmbledhur si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1015/2022

Avdyr BEKTESHI

Behteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Komisionit të Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

